



Data: 07.03.2019

Ref.: 387/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Ligjin për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 62-të, të mbajtur më 12 shkurt 2019, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa për aprovim të aplikacionit e Kolegjit Universum, Nr.1483/18, datë 31.10.2018 për akreditim të programit të studimit:
 - Dizajn, BA, 180, ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Kolegji Universum ka parashtruar kërkesë (Nr.1483/18, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim institucional dhe akreditim të programeve të studimit si në vijim: Infermieri, BSc, 180 ECTS; Dizajn, BA, 180 ECTS; Fizioterapi, BA, 180 ECTS, Diplomaci, MA, 120 ECTS, dhe Shkenca Politike, BA, 180 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KSHC në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019 ka trajtuar aplikacionin e Kolegji Universum, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1.2 të këtij neni, 10 të UA për Akreditim, në të cilin thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgaditët nga stafi i AKA-së", KShC erdhi në përfundim se programet e studimit: Dizajn, BA, 180, ECTS, nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim të aplikacionit.

Trajtimi i aplikacionit të Kolegjit Universum, është bërë duke u bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ (15/2018, datë 28.09.2018) për Akreditim të Institucioneve të Arsimit të Lartë sipas së cilit:

“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.

Meqenëse këto programi i përkasin fushës së arteve, trajtohen sipas UA 02/2019 datë 31.01.2019 për plotësim ndryshimin e nenit 26, pikës 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim 9/2018. Sipas këtij ndryshimi, për programet nga fusha e arteve, stafi akademik duhet të ketë gradën shkencore PhD, ose tituj të barasvlershëm artistik.

- Për programin e studimit: *Dizajn, BA, 180, ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Universum ka paraparë këta persona: Nizajete Qamili, Dafina Gashi-Ramadani, dhe Edona Daku.

Ky program ka 180 ECTS kredi dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program Kolegji Universum duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Meqenëse këto programi i përkasin fushës së arteve, trajtohen sipas UA 02/2019 datë 31.01.2019 për plotësim ndryshimin e nenit 26, pikës 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim 9/2018. Sipas këtij ndryshimi, për programet nga fusha e arteve, stafi akademik duhet të ketë gradën shkencore PhD, ose tituj të barasvlershëm artistik.


Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Kolegji Universum për këtë program të studimit, u konstatua që, të tre bartësit janë MA në arkitekturë, dhe asnjeri nga ta nuk i përket fushës së dizajnit. Nizajete Qamili është MA në Arkitekturë, Dafina Gashi-Ramadani, MA në Arkitekturë, dhe Edona Daku, MA në Arkitekturë.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Dizajn, BA, 180, ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “Universum”;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

